UDHËZIM
Nr. 225, datë 12.11.2024

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN E MINISTRIT TË BRENDSHËM NR. 64, DATË 12.5.2022, "PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE TË VEÇANTA TË DHËNIES SË CERTIFIKATËS PËR USHTRIMIN E AKTIVITETIT TË EKSPERTIT PRIVAT NË FUSHËN E MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPËTIMIN"

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës, pikës 4, të nenit 49, të ligjit nr. 152/2015, "Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin",

UDHËZOJ:

I. Në udhëzimin e ministrit të Brendshëm nr. 64, datë 12.5.2022, "Për përcaktimin e kritereve të veçanta të dhënies së certifikatës për ushtrimin e aktivitetit të ekspertit privat në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin", bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në kreun I, shkronja "c", e pikës 1, riformulohet si më poshtë:

c) "Kryerja e trajnimeve bazike në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin";

2. Në kreun 1, pika 1, pas shkronjës "c" shtohet shkronja "ç" me përmbajtje si vijon:

"ç) "Kryerja e trajnimeve të avancuara në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin".".

3. Në kreun I, shkronjat "a" dhe "c", të pikës 2 dhe pika 2.1 shfuqizohen.

4. Në kreun I, në shkronjën "a", të pikës 3, shtohet togfjalëshi "Inxhinieri Pyjore", "Inxhinieri Gjeodezi".

5. Në kreun I, shkronja "b", e pikës 3, riformulohet si më poshtë vijon:

"b) Të ketë 2 vite përvojë në fushën e projektimit të objekteve dhe të disponojë licencë profesionale individuale, studim e projektim në ndërtim, sipas përcaktimeve të nenit 17, pika 1, shkronja "a", të VKM-së nr. 759, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim", të ndryshuar.".

6. Në kreun I, pika 4 riformulohet si vijon:

"4. Subjektet, për t'u pajisur me certifikatë për "Kryerjen e trajnimeve bazike në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin", duhet të plotësojnë të paktën njërin nga kriteret e mëposhtme:

a) të kenë eksperiencë jo më pak se 3 vjet në shërbimin zjarrfikës, si punonjës të strukturave vendore të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin;

b) të disponojnë një certifikatë që provon se kanë kryer programin për trajnues për aktivitete me rrezik të ulët për trajnues, të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e MZSH-së;

c) të jenë të certifikuar në një nga qendrat e akredituara të trajnimit zjarrfikës jashtë vendit. Certifikata duhet të jetë e shoqëruar me programin e kursit të trajnimit për sigurinë nga zjarri.".

7. Në kreun I, pikat 4.1 dhe 4.2 shfuqizohen.

8. Në kreun I, shtohen pikat 5, 6 dhe 6.1, me përmbajtje si vijon:

"5. Subjektet, për t'u pajisur me certifikatë për "Kryerjen e trajnimeve të avancuara në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin", duhet të plotësojnë të paktën njërin nga kriteret e mëposhtme:

a) të kenë eksperiencë jo më pak se 5 vjet në shërbimin zjarrfikës, si punonjës të nivelit të mesëm dhe të lartë në strukturat e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin;

b) të disponojnë një certifikatë që provon se kanë kryer programin për trajnues për aktivitete me rrezik të mesëm dhe të lartë, të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e MZSH-së;

c) të jenë certifikuar në një nga qendrat e akredituara të trajnimit zjarrfikës jashtë vendit. Certifikata duhet të jetë e shoqëruar me programin e kursit të trajnimit për trajnues për aktivitete me rrezik të mesëm dhe të lartë.

6. Subjekti fizik i huaj, mund të aplikojë për certifikatë sipas shkronjave "c" dhe "ç", të pikës 1 të këtij kreu, duke plotësuar kriteret e përcaktuara në pikat 4 dhe 5 të këtij kreu, të ketë njësuar pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin, si dhe diplomën ekuivalente të lëshuar nga institucionet përkatëse të huaja.

6.1 Subjekti juridik vendas apo i huaj, mund të aplikojë për certifikatë sipas shkronjave "c" dhe "ç", të pikës 1 të këtij kreu, në emër të drejtuesit teknik të shoqërisë, i cili plotëson kriteret e përcaktuara në pikat 4 dhe 5 të këtij kreu.

9. Në kreun II, pika 3, riformulohet si vijon:

"3. Eksperti zjarrfikës i certifikuar për "Kryerjen e trajnimeve bazike në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin" kryen trajnime që lidhen me dhënien e njohurive bazike në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin për subjektet fizike dhe juridike që kryejnë një aktivitet të caktuar, të klasifikuar si aktivitet me rrezik të ulët zjarri.".

10. Në kreun II, pas pikës 3 shtohet pikat 4, 5, 6 dhe 7, me përmbajtje si vijon:

"4. Eksperti zjarrfikës i certifikuar për "Kryerjen e trajnimeve të avancuara në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin" kryen trajnime që lidhen me dhënien e njohurive të avancuara për subjektet fizike dhe juridike që kryejnë një aktivitet të caktuar, të klasifikuar si aktivitete me rrezik të mesëm dhe të lartë zjarri.

5. Njohuritë, aftësitë dhe kompetencat e ekspertit, të përcaktuara në pikat 3 dhe 4 të këtij kreu, bazohen në kriteret për menaxhimin e vendeve të punës, vlerësimin e rrezikut nga zjarri në funksionim dhe në raste emergjente, dhe karakteristikat specifike për parandalimin dhe mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin, kryesisht në:

a) respektimin e standardeve ligjore, tekniko-strukturore në lidhje me pajisjet, sistemet, vendet e punës, agjentët kimikë, fizikë të aktivitetit;

b) aktivitetet e identifikimit, vlerësimit të rrezikut dhe përgatitjen e masave të parandalimit dhe mbrojtjes pasive, aktive;

c) informimin e punonjësve dhe aktivitetet e trajnimit për sigurinë nga zjarri;

ç) aktivitetet mbikëqyrëse në lidhje masat e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin;

d) analizimin e dokumentacionit tekniko-ligjor për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin, dhe certifikimet e kërkuara;

dh) kontrollet periodike të aplikimit dhe efektivitetit të procedurave të miratuara për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin.

6. Ekspertët e përcaktuar në germën "c", të pikës 3 të këtij kreu, lejohen të trajnojnë aktivitete me numër punonjësish deri në 15 persona. Ekspertët e përcaktuar në germën "ç", të pikës 3, të këtij kreu, lejohen të trajnojnë një numër të pakufizuar punonjësish.

7. Programi minimal i kursit të trajnimit për sigurinë nga zjarri për aktivitete me rrezik të ulët, të mesëm dhe të lartë (modulet) janë sipas shtojcës 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi.".

11. Në kreun III, shkronjat "e" dhe "f", të pikës 1 shfuqizohen.

12. Në kreun III, pika 4 riformulohet si më poshtë:

"4. Të certifikuarit duhet të kryejnë trajnime ose seminare në fushën e parandalimit të zjarrit, të detyrueshme çdo pesë vjet, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të MZSH-së ose në një nga qendrat e akredituara, me një kohëzgjatje totale prej të paktën dyzet orësh, duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi. Në rast mospërmbushjeje të këtij detyrimi, certifikata e subjekteve do të pezullohet.".

13. Në kreun IV, pika 2 ndryshon me përmbajtje si vijon:

"2. Regjistri profesional është dokument fizik dhe elektronik, në përgjegjësi të Drejtorisë së Përgjithshme të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, ku regjistrohen të dhënat e certifikimit të subjekteve fizike dhe juridike, sa herë që ato trajtohen dhe u miratohet certifikimi, me të paktën parametrat:

a) emërtimi i subjektit të certifikuar;

b) numri unik i certifikatës profesionale;

c) data e lëshimit të certifikatës;

ç) adresa elektronike dhe numri i telefonit;

d) emërtimi i diplomës;

dh) rezidenca e subjektit.

Sekretariati Teknik i ngritur për mbështetjen e Komisionit të Posaçëm bën përditësimin e të dhënave në Regjistrin Profesional.".

14. Në kreun IV, shtohen pikat 3, 4 dhe 5 me përmbajtje si vijon:

"3. Në Regjistrin profesional publikohen vetëm të dhënat e të certifikuarve që përmbushin detyrimet e përcaktuara në këtë udhëzim.

4. Regjistri publik elektronik i të certifikuarve, sipas klasifikimit të pikës 1, të kreut I, afishohet në faqen zyrtare të Ministrisë së Brendshme, përditësohet sipas vendimmarrjes së Komisionit të Posaçëm dhe mundësohet aksesi në të, i çdo subjekti publik apo privat.

5. Formularët e certifikatës, sipas lidhjeve nr. 1, nr. 2, nr. 3 dhe nr. 4, bashkëlidhur këtij udhëzimi, hartohen në dy kopje të njëjta. Kryetari i Komisionit të Posaçëm i vendos si element sigurie "QR code", i cili përmban (emër, mbiemër dhe numrin unik të regjistrit të aplikuesit, si dhe emri i institucionit që lëshon këtë certifikatë, emërtimin e kategorisë së certifikatës). Drejtori i përgjithshëm i MZSH-së nënshkruan certifikatat në përputhje më vendimmarrjen e Komisionit të Posaçëm. Njëra nga certifikatat mbahet në arkivin e sekretariatit dhe kopja tjetër dorëzohet në arkiv-protokollin e institucionit të ministrisë, së bashku me njërën nga kopjet e vendimit të Komisionit të Posaçëm. Formulari me vulën elektronike i dorëzohet përfituesit/aplikuesit brenda afatit të përcaktuar në pikën 8 të udhëzimit.".

15. Kreu V riformulohet si më poshtë:

"V. DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

1. Certifikatat e miratuara dhe të lëshuara nga Drejtoria e Përgjithshme e MZSH-së, para hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi, do të konsiderohen të vlefshme. Subjektet fizike dhe juridike për të cilëve u janë miratuar këto certifikata, por që nuk figurojnë të regjistruar në regjistrin e përcaktuar në pikën 2 të këtij kreu, duhet të aplikojnë për pajisjen me formatin e miratuar bashkëlidhur këtij udhëzimi, pasi të kenë plotësuar më parë kriteret e përcaktuara në kreun I dhe III të këtij udhëzimi, brenda afatit 12-mujor, nga momenti i hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi. Pas këtij afati, certifikatat e parinovuara do të jenë të pavlefshme.

2. Subjektet fizike dhe juridike të cilëve u janë miratuar certifikatat sipas kritereve të veçanta dhe figurojnë të regjistruar në regjistrin e ekspertëve zjarrfikës privat, konsiderohen të vlefshme. Këto subjekte duhet të aplikojnë për t'u pajisur me formatet e miratuara (lidhjet) bashkëlidhur këtij udhëzimi brenda afatit 6-mujor, nga momenti i hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi. Komisioni i Posaçëm i parashikuar në pikën 2, të kreut III të udhëzimit, pajis subjektet me formatin e miratuar të certifikatave, bashkëlidhur këtij udhëzimi, duke rivlerësuar aplikimin në përputhje edhe me parashikimet e pikës 13 po të kreut III të tij.".

3. Udhëzimi nr. 11, datë 10.12.2002, i ministrit të Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit "Për kriteret profesionale të dhënies së lejes për ushtrimin e ekspertit privat zjarrfikës", shfuqizohet.

II. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohet Ministria e Brendshme dhe Drejtoria e Përgjithshme e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BRENDSHËM
Ervin Hoxha

SHTOJCA 1

PROGRAMI MINIMAL I KURSIT TË TRAJNIMIT PËR SIGURINË NGA ZJARRI PËR AKTIVITETE ME RREZIK TË ULËT, TË MESËM DHE TË LARTË (MODULET), I DETYRUESHËM PËR EKSPERTËT E CERTIFIKUAR "PËR KRYERJEN E TRAJNIMEVE NË FUSHËN E MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPËTIMIN"

A. PROGRAMI I KURSIT TË TRAJNIMIT PËR SIGURINË NGA ZJARRI PËR AKTIVITETE ME RREZIK TË ULËT

Moduli 1: Zjarri dhe parandalimi (1 orë)

- parimet e djegies;
- produktet e djegies;
- substancat shuarëse në lidhje me llojin e zjarrit;
- efektet e zjarrit te njerëzit;
- ndalimet dhe kufizimet e ushtrimit;
- masat e sjelljes.

Moduli 2: Procedurat dhe mbrojtjet për parandalimin e zjarrit që do të miratohen në rast zjarri (1 orë)

- masat kryesore të mbrojtjes nga zjarri;
- evakuimi në rast zjarri;
- thirrje për ndihmë.

Moduli 3: Ushtrime praktike (2 orë)

Rishikimi dhe sqarimi mbi aparatet e fikjes së zjarrit:

- ushtrime për përdorimin e aparateve lëvizshme për shuarjen e zjarrit.

B. PROGRAMI I KURSIT TË TRAJNIMIT PËR SIGURINË NGA ZJARRI PËR AKTIVITETE ME RREZIK TË MESËM

Moduli 1: Zjarri dhe parandalimi (2 orë) në aktivitete me rrezik të mesëm

- parimet e djegies;
- substancat shuarëse;
- trekëndëshi i djegies;
- shkaqet kryesore të zjarrit;
- rreziqet për njerëzit në rast zjarri;
- masat specifike të parandalimit të zjarrit;
- masat e sjelljes për të parandaluar zjarret.

Moduli 2: Procedurat dhe mbrojtjet për parandalimin e zjarrit që do të miratohen në rast zjarri (3 orë)

- masat kryesore të mbrojtjes nga zjarri;
- rrugët e eksodit;
- procedurat që duhet të merren kur zbulohet një zjarr ose në rast alarmi;
- procedurat për evakuim;

- marrëdhëniet me zjarrfikësen;
- pajisjet dhe sistemet e shuarjes;
- sisteme alarmi;
- shenjat e sigurisë;
- ndriçimi emergjent.

Moduli 3: Ushtrime praktike (3 orë)

- metodat më të zakonshme të shuarjes;
- rishikimi dhe sqarimet mbi pajisjet mbrojtëse personale;
- ushtrime për përdorimin e aparateve për fikjen e zjarrit dhe mënyrën e përdorimit të tubave dhe hidrantëve.

C. PROGRAMI I KURSIT TË TRAJNIMIT PËR SIGURINË NGA ZJARRI PËR AKTIVITETE ME RREZIK TË LARTË

Moduli 1: Zjarri dhe parandalimi (4 orë)

- parimet e djegies;
- shkaqet kryesore të zjarrit në lidhje me mjedisin specifik të punës;
- substancat shuarëse;
- rreziqet për njerëzit dhe mjedisin;
- masa specifike për parandalimin e zjarrit;
- masat e sjelljes për të parandaluar zjarret;
- rëndësia e kontrollit të vendit të punës;
- rëndësia e kontrolleve dhe mirëmbajtjes në pajisjet kundër zjarrit.

Moduli 2: Mbrojtja nga zjarri (4 orë)

- masat e mbrojtjes pasive;
- rrugët e arratisjes, ndarjet, distancat;
- pajisje dhe sistemet shuarëse - sisteme alarmi;
- shenjat e sigurisë;
- sisteme të sigurisë elektrike;
- ndriçimi i sigurisë.

Moduli 3: Procedurat që do të miratohen në rast zjarri (4 orë)

- procedurat që duhen marrë kur zbulohet një zjarr;
- procedurat që do të miratohen në rast alarmi;
- mënyra e evakuimit;
- si të telefononi shërbimet e urgjencës;
- bashkëpunimi me zjarrfikësen në rast ndërhyrjeje;
- ilustrimi i një situate emergjente dhe metodave procedurale-operacionale.

Moduli 4: Ushtrime praktike (4 orë)

- pajisjet dhe sistemet kryesore të shuarjes;
- pasi të keni lexuar pajisjet mbrojtëse personale (maska, aparate frymëmarrjeje të pavarura, kostume, etj.);
- ushtrime për përdorimin e pajisjeve për shuarjen e zjarrit dhe mbrojtjen individuale.

Lidhja nr.1

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPËTIMIT
KOMISIONI I POSAÇËM

Nr._____. prot. Tiranë, më____.____.2024

CERTIFIKATË

EKSPERT ZJARRFIKËS PRIVAT

(Për kryerjen e aktekspertimeve për zjarret e rëna)

Nr. Vendimi ____, datë ___.___.2024

NR.REGJ. PROFESIONAL _____

Mbiemri	
Emri	
Atësia	
Datëlindja	
Vendbanimi	
Diplomuar më datë:	
Titulli	
Regjistruar në regjistrin profesional:	

Fotografia

Z. Emër Mbiemër, certifikuar nga Komisioni i Posaçëm për klasifikimin e parashikuar nga shkronja "a" e pikës 1 të kreut I, të udhëzimit të Ministrit të Brendshëm nr.64, datë 12.05.2022 "Për kriteret e veçanta të dhënies se certifikatës, për ushtrimin e aktivitetit të Ekspertit Privat në fushën MZSH mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin", i ndryshuar.

KRYERJA E AKT-EKSPERTIMEVE PËR ZJARRET E RËNA

Detyrat e ekspertit për përcaktimin e origjinës dhe shkakut të zjarrit bazohen në aspektin procedural, kryesisht në parashikimet e: Seksionin VI (Ekspertimi) të Kodit të Procedurës Penale dhe Kreu VI (Eksperti dhe Ekspertimi) të Kodit të Procedurës Civile.

a. Funksionet kryesore të ekspertit të caktuar nga organi procedues, në kuadër të hetimit të zjarrit janë: studimi, hulumtimi, analiza për vlerësimin e shkaqeve të zjarrit, me qëllim sigurimin e mbështetjes kryesisht për organet kompetente të policisë gjyqësore për aktivitetet hetimore në lidhje me ndodhjen e aksidenteve të karakterizuara nga zjarri.
b. Vlerësimi dhe analiza e vendit të ngjarjes: Eksperti i caktuar inspekton dhe dokumenton vendin ku ka ndodhur zjarri për të përcaktuar origjinën dhe mënyrën e përhapjes së tij.
c. Vlerësimi i provave: analizon prova fizike nga vendi i ngjarjes (zjarrit/shpërthimit) si mbetje, materiale djegëse, dhe sende të tjera që mund të ndihmojnë në përcaktimin e shkakut të zjarrit.
d. Fotografimi për të dokumentuar vendin dhe kushtet pas zjarrit, analizimi i procesverbaleve hetimore dhe dëshmive dhe palëve të përfshira, që mund të kenë informacione të rëndësishme për zjarrin.
e. Analiza e shkakut të zjarrit, për të analizuar burimin e zjarrit dhe faktorët që kanë kontribuar në shpërthimin dhe përhapjen e tij.
f. Bashkëpunon me shërbimet e Policisë, shërbimet zjarrfikëse dhe agjencitë e sigurisë për të dhënë raportime dhe dëshmi teknike.
g. Përgatitja e raporteve për origjinën dhe shkakun e zjarrit, të cilat përdoren nga organet ligjore.
h. Në raste kur vlerësohet e nevojshme, eksperti mund të thirret për të dhënë dëshmi si ekspert në gjykatë, duke shpjeguar vlerësimet e tij teknike në lidhje me zjarrin.
i. Përcaktimi i saktë i origjinës dhe shkakut të zjarrit, bazuar në prova dhe analiza shkencore.
j. Dokumentimi i saktë dhe i detajuar për çdo aspekt, duke përfshirë fotografitë, diagramet e vendit të zjarrit, dhe raportet e shkruara.
k. Përdorimi i standardeve dhe metodave shkencore, për të siguruar një hetim të paanshëm dhe të saktë.
l. Përgjegjësia për të qëndruar i përditësuar me teknologjitë dhe metodat e reja në fushën e hetimeve të zjarrit për të përmirësuar efikasitetin e punës.
m. Njohuri të thella teknike të thelluara mbi dinamikën e zjarrit, përfshirë mënyrën e përhapjes së tij, materialet djegëse, dhe faktorët që ndikojnë në shkaktimin dhe përhapjen e zjarreve.
n. Aftësi analitike dhe kritike, për të nxjerrë përfundime të sakta lidhur me origjinën dhe shkakun e zjarrit.

DREJTORI I PËRGJITHSHËM

_____

Lidhja nr.2

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPËTIMIT
KOMISIONI I POSAÇËM

Nr._____. prot. Tiranë, më____.____.2024

CERTIFIKATË

EKSPERT ZJARRFIKËS PRIVAT

(Për hartimin e projekteve të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin)
Nr. Vendimi _____, datë ___.___.2024

NR.REGJ. UNIK _____

Mbiemri	
Emri	
Atësia	
Datëlindja	
Vendbanimi	
Diplomuar më datë	
Titulli	
Regjistruar në Regjistrin profesional:	

Fotografia

Z. Emër Mbiemër, certifikuar nga Komisioni i Posaçëm për klasifikimin e parashikuar nga shkronja "b" e pikës 1 të kreut I, të udhëzimit të Ministrit të Brendshëm nr.64, datë 12.05.2022 "Për kriteret e veçanta të dhënies se certifikatës, për ushtrimin e aktivitetit të Ekspertit Privat në fushën MZSH mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin", i ndryshuar.

HARTIM I PROJEKTEVE TË MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPËTIMIN

Shërbimet që ofrohen nga ekspertë që pajisjen me certifikatë të tipit: "*Për hartimin e dokumentacionit të projekteve teknike për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin*" konsistojnë në:

a. Hartimi i dokumentacionit të projektit dhe vizatimeve grafike (dizajni);
b. Studimet e fizibilitetit, buxhetet e investimeve për parandalimin, monitorimin dhe sistemet aktive dhe pasive të mbrojtjes nga zjarri në impiantet industriale;
c. Llogaritjet bazë të sistemeve të monitorimit dhe zbulimit të tymit, gazit dhe zjarrit, mbrojtjes aktive dhe pasive të zjarrit.
d. Vlerësimi i shkallës së sigurisë funksionale në lidhje me sistemet e zjarrit dhe gazit në lidhje me standardet e referencës (IEC IEC 61508 / CEI IEC 61511-1:2016).
e. Përkufizimi i planeve dhe ndërhyrjes sipas skenarëve të zjarrit të identifikuara nga analiza e rrezikut të zjarrit ose nga analiza e rrezikut të aksidenteve të mëdha;
f. Përgatitja e specifikimeve teknike për kërkesën e furnizimit të materialeve dhe pajisjeve për sistemet e mbrojtjes nga zjarri, si dhe asistencë teknike për vlerësimin teknik të ofertave;
g. Auditimet e projektit dhe përputhshmëria me rregulloret kombëtare dhe ndërkombëtare në lidhje me sistemet e mbrojtjes nga zjarri;
h. Kontrolle praktike për efikasitetin dhe pajtueshmërinë me projektimin e sistemeve të mbrojtjes nga zjarri me ujë dhe shkumë, si dhe verifikimi hidraulik i rrjeteve hidrike dhe sistemeve të spërkatës (me mbështetjen e kodeve të llogaritjes së specializuara);
i. Asistencë për testet praktike të evakuimit nga aktivitetet me frekuentim të konsiderueshëm banorësh dhe zonat operative me referencë të veçantë në skenarët hipotetik të aksidenteve;
j. Analizat dhe aktivitetet e simulimit me kodet e llogaritjes së avancuar (p.sh. CFD) për verifikimin e performancës në rast zjarri si pjesë e qasjes së performancës ndaj Inxhinierisë së Zjarrit në përputhje me dispozitat e rregullave kombëtare dhe sipas standardeve ndërkombëtare referuese;
k. Kryerja e kontrolleve specifike për të përcaktuar rrezikun e zjarrit me qëllim identifikimin e "skenarëve të projektit", si dhe vlerësimi i rrezikut të zjarrit përmes sesioneve të analizave me aplikimin e metodologjive bashkëkohore;
l. Analizat dhe aktivitetet e simulimit me kodet llogaritëse të avancuara të ecurisë së sistemit të eksodit në kushtet e emergjencave;
m. Aktiviteti i analizës, simulimi me kodet specifike llogaritëse dhe verifikimi i performancës së sistemit të ndriçimit të zonave të aktiviteteve të procesit dhe mjediseve të punës, me qëllim të verifikimit të operueshmërisë (gjithashtu në përputhje me standardet referuese) dhe me qëllim të verifikimit të disponueshmërisë së ndriçimit në kushtet e evakuimit emergjent;
n. Verifikimi i qëndrueshmërisë së ekipit emergjent të zjarrit në lidhje me skenarët e referencës së aksidentit dhe auditimi i planifikimit emergjent të zjarrit.
o. Aktivitetet e ekspertëve të zjarrit së zjarrit dhe mbështetja për përgatitjen e dokumentacionit teknik për qëllime të parandalimit të zjarrit kryhen edhe me përdorimin e Rregullave Teknike Horizontale, vertikale, në përputhje me standardet teknike për parandalimin e zjarrit.
p. Certifikimi i rezistencës ndaj zjarrit, pajtueshmëria rregullatore

DREJTORI I PËRGJITHSHËM

_____

Lidhja nr.3

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPËTIMIT
KOMISIONI I POSAÇËM

Nr._____ prot. Tiranë, më____.____.2024

CERTIFIKATË

EKSPERT ZJARRFIKËS PRIVAT

(Për kryerjen e trajnimeve bazike në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin)
Nr. Vendimi ____, datë ___.___.2024

NR.REGJ. PROFESIONAL _____

Mbiemri	
Emri	
Atësia	
Datëlindja	
Vendbanimi	
Diplomuar, më datë	
Titulli	
Regjistruar në regjistrin profesional:	

Fotografia

Z. Emër Mbiemër, certifikuar nga Komisioni i Posaçëm për klasifikimin e parashikuar nga shkronja "c" e pikës 1 të kreut I, të udhëzimit të Ministrit të Brendshëm nr.64, datë 12.05.2022 "Për kriteret e veçanta të dhënies se certifikatës, për ushtrimin e aktivitetit të Ekspertit Privat në fushën MZSH mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin", i ndryshuar.

TRAJNUES PËR NJOHURI BAZIKE NË FUSHËN E MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPËTIMIN

Programi minimal i detyrueshëm i kursit të sigurisë nga zjarri është i bazuar në rrezikun e treguar në një fazë analize fillestare nëpërmjet "Hartimit të Dokumentit të Vlerësimit të Riskut (DVR). Klasifikimi në aktivitete me rrezik të ulët, të mesëm dhe të lartë. Përmbajtja minimale e kursit duhet të përfshijë trajtimin dhe parandalimin e zjarreve, mbrojtjen nga zjarri dhe procedurat që duhen miratuar në rast zjarri, sipas moduleve:

Moduli 1. Parandalimi i zjarrit
a. Parimet e djegies
b. Shkaqet kryesore të zjarrit në lidhje me mjedisin specifik të punës
c. Substancat shuarëse
d. Rreziqet për njerëzit dhe mjedisin
e. Masat specifike të parandalimit të zjarrit
f. Masat e sjelljes për parandalimin e zjarreve
g. Rëndësia e kontrollit të mjediseve të punës
h. Rëndësia e kontrolleve dhe mirëmbajtjes së pajisjeve kundër zjarrit

Moduli 2. Mbrojtja nga zjarri
a. Masat e mbrojtjes pasive
b. Rrugët e arratisjes, ndarjet, ndarjet
c. Pajisjet dhe sistemet e fikjes
d. Sistemet e alarmit
e. Shenjat e sigurisë
f. Sistemet elektrike të sigurisë
g. Ndriçimi i sigurisë

Moduli 3.Pprocedurat që duhen miratuar në rast zjarri

a. Procedurat që duhen miratuar kur zbulohet një zjarr
b. Procedurat që duhen miratuar në rast alarmi
c. Metodat e evakuimit
d. Si të telefononi shërbimet e urgjencës
e. Bashkëpunimi me zjarrfikësit në rast ndërhyrjeje
f. Shembulli i një situate emergjente dhe metodave procedurale-operacionale

Moduli 4. Ushtrime praktike

a. Rishikim dhe sqarime mbi pajisjet dhe sistemet kryesore të fikjes së zjarrit.
b. Pas ekzaminimit të pajisjeve mbrojtëse personale (maska, aparate të frymëmarrjes, kominoshe, etj.)
c. Ushtrime për përdorimin e pajisjeve të fikjes së zjarrit dhe mbrojtjes personale

DREJTORI I PËRGJITHSHËM

_____

Lidhja nr.4

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPËTIMIN
KOMISIONI I POSAÇËM

Nr._____. prot. Tiranë, më____.____.2024

CERTIFIKATË

EKSPERT ZJARRFIKËS PRIVAT

(Për kryerjen e trajnimeve të avancuara në fushën e sigurisë nga zjarri)
Nr. Vendimi ____, datë ___.___.2024

NR.REGJ. PROFESIONAL _____

Mbiemri	
Emri	
Atësia	
Datëlindja	
Vendbanimi	
Diplomuar më datë	
Titulli	
Regjistruar në regjistrin profesional:	

Fotografia

Z/Znj. Emër Mbiemër, certifikuar nga Komisioni i Posaçëm për klasifikimin e parashikuar nga shkronja "ç" e pikës 1 të kreut I, të udhëzimit të Ministrit të Brendshëm nr.64, datë 12.05.2022 "Për kriteret e veçanta të dhënies se certifikatës, për ushtrimin e aktivitetit të Ekspertit Privat në fushën MZSH mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin", i ndryshuar.

TRAJNUES PËR NJOHURI TË AVANCUARA NË FUSHËN E MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPËTIMIN

Programi minimal i detyrueshëm i kursit të sigurisë nga zjarri është i bazuar në rrezikun e treguar në një fazë analize fillestare nëpërmjet "Hartimit të Dokumentit të Vlerësimit të Riskut (DVR). Klasifikimi në aktivitete me rrezik të ulët, të mesëm dhe të lartë. Përmbajtja minimale e kursit duhet të përfshijë trajtimin dhe parandalimin e zjarreve, mbrojtjen nga zjarri dhe procedurat që duhen miratuar në rast zjarri, sipas moduleve:

Moduli 1. Parandalimi i zjarrit
a. Parimet e djegies
b. Shkaqet kryesore të zjarrit në lidhje me mjedisin specifik të punës
c. Substancat shuarëse
d. Rreziqet për njerëzit dhe mjedisin
e. Masat specifike të parandalimit të zjarrit
f. Masat e sjelljes për parandalimin e zjarreve
g. Rëndësia e kontrollit të mjediseve të punës
h. Rëndësia e kontrolleve dhe mirëmbajtjes së pajisjeve kundër zjarrit

Moduli 2. Mbrojtja nga zjarri
a. Masat e mbrojtjes pasive
b. Rrugët e arratisjes, ndarjet, ndarjet
c. Pajisjet dhe sistemet e fikjes
d. Sistemet e alarmit
e. Shenjat e sigurisë
f. Sistemet elektrike të sigurisë
g. Ndriçimi i sigurisë

Moduli 3.Pprocedurat që duhen miratuar në rast zjarri

a. Procedurat që duhen miratuar kur zbulohet një zjarr
b. Procedurat që duhen miratuar në rast alarmi
c. Metodat e evakuimit
d. Si të telefononi shërbimet e urgjencës
e. Bashkëpunimi me zjarrfikësit në rast ndërhyrjeje
f. Shembulli i një situate emergjente dhe metodave procedurale-operacionale

Moduli 4. Ushtrime praktike
a. Rishikim dhe sqarime mbi pajisjet dhe sistemet kryesore të fikjes së zjarrit.
b. Pas ekzaminimit të pajisjeve mbrojtëse personale (maska, aparate të frymëmarrjes, kominoshe, etj.)
c. Ushtrime për përdorimin e pajisjeve të fikjes së zjarrit dhe mbrojtjes personale.

DREJTORI I PËRGJITHSHËM

_____